

VENDIM
Nr. 89, datë 3.10.2014

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJEVE NË KUADËR TË SIGURIMIT TË KREDISË
NGA BANKA BOTËRORE PËR PROJEKTIN PËR RIMËKËMBJEN E SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (të ndryshuar), vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013, “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij” (të ndryshuar), Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 3.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për dhënie të autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të sigurimit të kredisë nga Banka Botërore për projektin për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

konstatoi se:

Për finalizimin e procedurave për sigurimin e kredisë prej 150 000 000 (150 milionë) dollarësh ndërmjet Bankës Botërore dhe palëve të sektorit të energjisë elektrike nevojitet nënshkrimi i marrëveshjes së huas, dhe marrëveshjeve përkatëse, për projekte specifike. Për këtë duhet që administratori i shoqërisë OSHEE sh.a. të ketë të gjitha kompetencat për ndjekjen e procedurave të nevojshme për nënshkrimin e marrëveshjes së huas, si dhe marrëveshjeve të tjera në funksion të projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. T’i japë autorizimin e posaçëm z. Arben Seferaj për nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të sigurimit të kredisë nga Banka Botërore për projektin për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të personat e interesuar lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti